



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

PROJEKT LIGJ

Nr. _____/2026

**“PËR KONTRIBUTIN KOMBËTAR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË
BUXHETIN E BASHKIMIT EVROPIAN”**

Në mbështetje të neneve 78, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

VENDOSI:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Objekti i ligjit

Ky ligj përcakton kuadrin institucional, rregullat dhe procedurat për përlogaritjen, planifikimin, raportimin, financimin dhe vënien në dispozicion të Kontributit Kombëtar të Republikës së Shqipërisë në buxhetin e Bashkimit Evropian, si dhe përgjegjësitë e institucioneve të përfshira në këtë proces, në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian për Burimet e Veta.

Neni 2

Fusha e zbatimit të ligjit

Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të gjitha institucionet publike që prodhojnë, administrojnë, përpunojnë, raportojnë, kontrollojnë ose auditojnë të dhëna të nevojshme për përlogaritjen dhe administrimin e Kontributit Kombëtar.

Neni 3

Përkufizimet

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **"Kontributi Kombëtar"** është kontributi nga burimet e veta i Republikës së Shqipërisë në buxhetin e Bashkimit Evropian dhe përfshin burimet tradicionale vetjake, burimin e bazuar në tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH), burimin e bazuar në të ardhurat kombëtare bruto (GNI) dhe burime të tjera të përcaktuara në legjislacionin e Bashkimit Evropian.
2. **"Burimet Tradicionale të Veta"** janë të ardhurat që rrjedhin nga detyrimet doganore të Tarifës së Përbashkët Doganore dhe nga detyrimet e tjera të vendosura ose që do të vendosen nga institucionet e Bashkimit Evropian për tregtinë me vendet e treta, si dhe nga detyrimet doganore për produktet që rregulloheshin nga Traktati për themelimin e Komunitetit Evropian të Qymyrit dhe Çelikut, në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian.
3. **"Burimet e Veta të Bazuara në TVSH"** janë kontributi financiar i llogaritur si përqindje e bazës së harmonizuar të TVSH-së, në përputhje me normën, rregullat dhe metodologjinë e përcaktuara në legjislacionin e Bashkimit Evropian.
4. **"E Ardhura Kombëtare Bruto (AKB)"** është statistikë zyrtare sipas Programit të Statistikave Zyrtare, e cila përfshihet në fushën e statistikave makroekonomike dhe mat vlerën gjithsej të të ardhurave primare të krijuara nga njësitë institucionale rezidente të një ekonomiegjatë një periudhës të caktuar, pavarësisht nëse këto të ardhura gjenerohen brenda territorit ekonomik të vendit apo nga marrëdhëniet me pjesën tjetër të botës. Përdoret nga Eurostat dhe Komisioni Evropian për llogaritjen e bazës së kontributit të shteteve anëtare në buxhetin e Bashkimit Evropian.
5. **"Burimet e Veta Bazuar në AKB"** është kontributi që secili shtet anëtar i BE-së paguan në buxhetin e Bashkimit Evropian, i llogaritur duke aplikuar një normë uniforme mbi Të Ardhurat Kombëtare Bruto të harmonizuara sipas metodologjisë ESA 2010 dhe akteve të BE-së për AKB.
6. **"Burimet e Veta të bazuara në Mbetjet e Paketimit Plastik të Pa Ricikluara"** janë kontributet financiare të llogaritura mbi bazën e sasisë së mbetjeve të paketimit plastik që nuk riciklohen, sipas metodologjisë dhe procedurave të përcaktuara në legjislacionin e Bashkimit Evropian.
7. **"Pronari i të Dhënave"** është institucioni publik ose njësia përgjegjëse për krijimin, administrimin, cilësinë, integritetin, sigurinë dhe disponueshmërinë e një grupi të caktuar të dhënash, si dhe për gatimin e saktësisë së tyre për qëllime raportimi.
8. **"Metadata¹"** janë të dhënat dhe çdo dokumentacion tjetër që përshkruan të dhënat statistikore dhe proceset statistikore në një mënyrë të standardizuar, duke siguruar informacion mbi burimin e të dhënave, metodologjinë, përkufizimet, klasifikimet dhe cilësinë e të dhënave.

¹ Sipas terminologjisë së përdorur nga Eurostat dhe INSTAT.

9. **"Gjurmë Auditi"** është dokumentacioni dhe evidenca që mundësojnë identifikimin, verifikimin dhe ndjekjen e plotë të procesit të mbledhjes, përpunimit, korrigjimit, transmetimit dhe raportimit të të dhënave, nga burimi fillestar deri në përdorimin e tyre përfundimtar.
10. **"Baza Kombëtare e të Dhënave për Burimet e Veta të Bashkimit Evropian"** (në vijim "Baza e të Dhënave"), është baza e konsoliduar e të dhënave, e cila përmban informacionin e siguruar nga institucionet përgjegjëse dhe përdoret për përlllogaritjen, verifikimin, raportimin dhe vënien në dispozicion të Burimeve të Veta të Bashkimit Evropian.
11. **"Llogaria e Kontributit Kombëtar"** është llogaria bankare në pronësi të Republikës së Shqipërisë, e hapur dhe e administruar pranë Bankës së Shqipërisë nga ministria përgjegjëse për financat, në të cilën arkëtohen kontributet nga burimet e veta dhe nga e cila kryhen transferimet përkatëse në buxhetin e Bashkimit Evropian.
12. **"Llogaria A"**² është llogaria e administruar nga autoriteti doganor, në të cilin regjistrohen të drejtat e konstatuara që lidhen me Burimet Tradicionale të Veta, për të cilat shuma e detyrimit është përcaktuar, debitori është identifikuar dhe nuk ekziston asnjë pengesë administrative ose gjyqësore që pengon arkëtimin ose vënien e tyre në dispozicion të Bashkimit Evropian.
13. **"Llogaria B"**³ është llogaria e administruar nga autoriteti doganor, në të cilin regjistrohen të drejtat e konstatuara që lidhen me Burimet Tradicionale të Veta, të cilat nuk janë arkëtuar ende dhe për të cilat ekziston një procedurë administrative ose gjyqësore në zhvillim, një kundërshtim i detyrimit, ose një pengesë tjetër që vonon arkëtimin e tyre. Shumat e regjistruara në Llogarinë B vihen në dispozicion të Bashkimit Evropian vetëm pas arkëtimit efektiv të tyre, në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian.
14. **"E drejtë e konstatuar"**⁴ është e drejta financiare që lind kur autoriteti kompetent ka përcaktuar shumën e detyrimit, ka identifikuar debitorin dhe ka vendosur ligjërisht detyrimin për pagesë, në përputhje me legjislacionin doganor dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian për Burimet Tradicionale Vetjake.
15. **"Shumë e paarkëtueshme"**⁵ është një e drejtë e konstatuar e regjistruar në Llogarinë B, për të cilën autoriteti kompetent ka provuar se arkëtimi nuk është i mundur, pavarësisht ndërmarrjes së të gjitha masave të nevojshme administrative dhe ligjore për mbledhjen e saj.
16. **"Inventari i AKB-së"** është dokumenti që ofron përshkrimin e plotë të burimeve të të dhënave, metodave dhe procedurave të përdorura për përlllogaritjen e të Ardhurave Kombëtare Bruto (AKB), përfshirë edhe rregullimet statistikore me qëllim sigurimin e mbulueshmërisë së plotë (ekzhaustivitetin), saktësisë dhe përputhshmërisë me konceptet dhe përkufizimet e ESA 2010.

² Përkufizim i harmonizuar me terminologjinë e përdorur në Rregulloren (EU, Euratom) Nr. 609/2014

³ Përkufizim i harmonizuar me terminologjinë e përdorur në Rregulloren (EU, Euratom) Nr. 609/2014

⁴ Përkufizim i harmonizuar me terminologjinë e përdorur në Rregulloren (EU, Euratom) Nr. 609/2014

⁵ Përkufizim i harmonizuar me terminologjinë e përdorur në Rregulloren (EU, Euratom) Nr. 609/2014

17. **"Sistemi i Kontrollit të Cilësisë së të Dhënave"**, është tërësia e procedurave, kontrolleve dhe mekanizmave që sigurojnë saktësinë, plotësinë, konsistencën, krahasueshmërinë dhe afatshmërinë e të dhënave të përdorura për Burimet Vetjake.
18. **"Autoriteti Kombëtar Koordinues për Kontributin Kombëtar në Bashkimin Evropian"** është ministria përgjegjëse për financat dhe është autoriteti përgjegjës për koordinimin institucional dhe vënien në dispozicion të Kontributit Kombëtar.
19. **"Koordinatori Kombëtar për Burimet e Veta të Bashkimit Evropian"** është njësi strukturore e veçantë pranë ministrisë përgjegjëse për financat, përgjegjëse për përlogaritjen teknike të Kontributit Kombëtar, administrimin e të dhënave që lidhen me Burimet e Veta dhe raportimin e tyre pranë institucioneve të Bashkimit Evropian, në përputhje me kërkesat dhe afatet e përcaktuara nga legjislacioni i Bashkimit Evropian. Kjo njësi luan rolin e Sekretariatit Teknik për Komitetin Kombëtar për Burimet e Veta të Bashkimit Evropian.
20. **"Komiteti Kombëtar për Kontributin Kombëtar në Bashkimin Evropian"** është organi më i lartë politik përgjegjës për drejtimin strategjik dhe mbikëqyrjen politike të procesit të kontributit të Republikës së Shqipërisë në buxhetin e Bashkimit Evropian, me qëllim garantimin e përputhshmërisë së tij me kuadrin ligjor dhe detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni i Bashkimit Evropian..
21. **"Programi i statistikave zyrtare"** ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 17/2018, "Për statistikat zyrtare", të ndryshuar.

KREU II

KORNIZA INSTITUCIONALE

Neni 4

Komiteti Kombëtar për Kontributin Kombëtar në BE

1. Komiteti Kombëtar për Kontributin Kombëtar në BE kryesohet nga Ministri përgjegjës për financat dhe ka në përbërjen e tij:
 - a. Sekretarin e Përgjithshëm të ministrisë përgjegjëse për financat;
 - b. Ministrin përgjegjës për mjedisin;
 - c. Titullarin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit;
2. Në mbledhjet e Komitetit Kombëtar për Kontributin Kombëtar në BE ftohen të marrin pjesë edhe Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it dhe përfaqësues të institucioneve të tjera, sipas çështjeve që shqyrtohen.
3. Komiteti Kombëtar për Kontributin Kombëtar në BE ka këto përgjegjësi:

- a) siguron kuadrin e nevojshëm për bashkërendimin institucional për përmbushjen e detyrimeve që lidhen me Kontributin Kombëtar në buxhetin e Bashkimit Evropian;
 - b) shqyrton problematikat ndërinstitutionale që ndikojnë në përlllogaritjen, raportimin ose financimin e Kontributit Kombëtar dhe përcakton orientimet e nevojshme për adresimin e tyre;
 - c) mbikëqyr përmbushjen e detyrimeve të institucioneve përgjegjëse sipas këtij ligji;
 - ç) shqyrton raportet periodike të Autoritetit Kombëtar Koordinues për ecurinë e procesit dhe masat e propozuara për përmirësimin e tij;
 - d) mbështet bashkërendimin e përgatitjeve institucionale për zbatimin e acquis të Bashkimit Evropian në fushën e Burimeve Vetjake.
4. Komiteti Kombëtar për Kontributin Kombëtar në Bashkimin Evropian mbështetet nga Sekretariati Teknik, i cili kryen funksione administrative dhe koordinuese për përgatitjen e materialeve, dokumentacionit dhe ndjekjen e çështjeve të shqyrtuara nga.
 5. Këshilli i Ministrave miraton, me propozim të ministrit përgjegjës për financat, rregullat e hollësishme për organizimin dhe funksionimin e Komitetit Kombëtar dhe të Sekretariatit Teknik..

Neni 5

Ministria përgjegjëse për financat

1. Ministria përgjegjëse për financat, në cilësinë e Autoritetit Kombëtar Koordinues, kryen këto detyra:
 - a) bashkërendon institucionet përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin, verifikimin dhe raportimin e të dhënave të nevojshme për përlllogaritjen e Kontributit Kombëtar;
 - b) konsolidon të dhënat e siguruara nga institucionet përgjegjëse për prodhimin dhe verifikimin e të dhënave që lidhen me Burimet e Veta të Bashkimit Evropian;
 - c) përgatit parashikimet për burimet e veta të Bazuara në TVSH për periudhën afatmesme;
 - d) kryen përlllogaritjen e Burimeve të Veta të bazuara në TVSH;
 - e) kryen përlllogaritjen e bazës së harmonizuar të TVSH-së për qëllime të vlerësimit të burimeve të bazuara në TVSH;
 - f) përgatit parashikimet makroekonomike për sigurimin e projeksioneve të të Ardhurës Kombëtare Bruto për vitin buxhetor dhe periudhën afatmesme, për qëllime të planifikimit të Kontributit Kombëtar në buxhetin e Bashkimit Evropian, si pjesë e ligjit vjetor të buxhetit; siguron planifikimin dhe kryerjen në kohë të

pagesave të Kontributit Kombëtar nga buxheti i shtetit në buxhetin e Bashkimit Evropian, në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e sistemit buxhetor;

- g) përgatit dhe transmeton raportimet zyrtare pranë Komisionit Evropian dhe institucioneve të tjera të Bashkimit Evropian, sipas kërkesave dhe afateve të përcaktuara nga legjislacioni i Bashkimit Evropian;
- h) administron Bazën Kombëtare të të Dhënave për Burimet e Veta të Bashkimit Evropian dhe siguron përditësimin e rregullt të tij;
- i) bashkërendon proceset e verifikimit, kontrollit dhe vlerësimit të kryera nga institucionet e Bashkimit Evropian në fushën e Burimeve të Veta;
- j) kërkon dhe merr, në përputhje me legjislacionin në fuqi, informacion dhe dokumentacion nga institucionet publike përgjegjëse për përpunimin, verifikimin dhe raportimin e të dhënave të nevojshme për përllogaritjen e Kontributit Kombëtar

2. Autoriteti Kombëtar Koordinues siguron që proceset e mbledhjes, përpunimit dhe raportimit të të dhënave për Kontributin Kombëtar të mbështeten në të dhëna të gjurmueshme, të verifikueshme dhe të dokumentuara, në përputhje me kërkesat e Bashkimit Evropian, dhe siguron ruajtjen e tyre për një periudhë deri në 10 vjet.

Neni 6

Instituti i Statistikave

1. Në përputhje me standardet e legjislacionit për statistikat zyrtare dhe kërkesat e këtij ligji, INSTAT është autoriteti kombëtar statistikor përgjegjës për prodhimin e AKB-së dhe ushtron funksionet e mëposhtme:
 - a) Përgatit propozimet metodologjike dhe aktivitetet zbatuese që lidhen me Llogaritjen e AKB-së, për tu përfshirë në Programin e Statistikave Zyrtare dhe Planin Vjetor për zbatimin e tij, në përputhje me kërkesat dhe standardet e akteve të BE-së dhe legjislacionin për statistikat zyrtare.
 - b) përpunon të dhënat e aksesuara nëpërmjet Bazës Kombëtare të të Dhënave për Burimet e Veta të Bashkimit Evropian dhe prodhon statistikat e të Ardhurave Kombëtare Bruto sipas ESA 2010;
 - c) transmeton në Eurostat të dhënat vjetore të AKB, rivlerësimet për AKB e viteve të kaluara, pyetësin vjetor të AKB dhe dokumentacionin metodologjik;
 - ç) garanton dokumentimin metodologjik, ruan evidencat dhe dokumentacionin mbështetës të përllogaritjes së AKB-së sipas Programit të Statistikave Zyrtare;
 - d) harton Inventarin Kombëtar të AKB-së;

dh) bashkëpunon me Eurostat-in gjatë proceseve të verifikimit të përlllogaritjes së AKB-së;

e) publikon dhe transmeton treguesit e AKB-së tek përdoruesit;

ë) në koordinim dhe me mbështetjen e Autoritetit Kombëtar Koordinues, ndërmerr çdo veprimtari tjetër që ndikon në përmirësimin e burimeve administrative dhe transmetimin e të dhënave për llogaritjen e AKB-së.

Neni 7

Përgjegjësitë e Administratës Doganore

1. Administrata Doganore është përgjegjëse për konstatimin, administrimin, mbledhjen dhe raportimin e Burimeve Tradicionale të Veta, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe atë të Bashkimit Evropian.
2. Sistemet elektronike të Administratës Doganore sigurojnë ndërveprueshmërinë me Regjistrin Kombëtar të Kontributit Kombëtar, si dhe mundësojnë prodhimin dhe shkëmbimin e të dhënave të kërkuara nga sistemi i raportimit të rasteve të mashtrimit dhe parregullsive që prekin burimet tradicionale vetjake të Bashkimit Evropian, si dhe nga sistemet e tjera përkatëse të Komisionit Evropian.
3. Administrata doganore:
 - a) administron, mbledh dhe kontabilizon Burimet Tradicionale të Veta në përputhje me legjislacionin doganor kombëtar dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian, si dhe mban përgjegjësi financiare për rastet e humbjes së të ardhurave kur kjo parashikohet nga legjislacioni i Bashkimit Evropian;
 - b) siguron vendosjen, mbledhjen dhe transferimin në kohë të detyrimeve doganore dhe të ardhurave të tjera që përbëjnë Burime Tradicionale të Veta;
 - c) zbaton legjislacionin doganor të Bashkimit Evropian, përfshirë masat tarifore dhe politikat tregtare që lidhen me mbledhjen e Burimeve Tradicionale të Veta;
 - d) garanton regjistrimin, gjurmueshmërinë dhe integritetin e të dhënave nëpërmjet sistemeve elektronike të administrimit doganor;
 - e) administron Llogarinë “A” dhe Llogarinë “B”, përgatit dhe transmeton raportet dhe pasqyrat përkatëse në përputhje me kërkesat dhe afatet e përcaktuara nga legjislacioni i Bashkimit Evropian, duke informuar edhe ministrinë përgjegjëse për financat;

- f) vë në dispozicion të Komisionit Evropian dhe ministrisë përgjegjëse për financat të dhënat, evidencat dhe dokumentacionin shoqërues që lidhen me Burimet Tradicionale të Veta, në përputhje me kërkesat e legjislacionit të Bashkimit Evropian.
4. Administrata Doganore është përgjegjëse për identifikimin, regjistrimin, dokumentimin dhe raportimin e rasteve të mashtrimeve, parregullsive dhe mospërputhjeve që lidhen me Burimet Tradicionale të Veta, në përputhje me Rregulloren (BE, Euratom) Nr. 609/2014, aktet zbatuese të Komisionit Evropian dhe procedurat e sistemit të raportimit të rasteve të mashtrimit dhe parregullsive që prekin burimet tradicionale vetjake të Bashkimit Evropian.
 5. Administrata Doganore është përgjegjëse për sigurimin e të dhënave të sakta mbi importet, TVSH-në e mbledhur në import, korigjime të tjera sipas Direktivës, gjobat dhe interesat dhe ia përcjell ministrisë përgjegjëse për financa sipas afateve të përcaktuar në këtë ligj;
 6. Procedurat e administrimit të Llogarisë "A" dhe "B", formatet e raportimit, shkëmbimi elektronik i të dhënave dhe përdorimi i formularëve standard të Komisionit Evropian, në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian, përcaktohen me udhëzim nga Ministri përgjegjës për financat.

Neni 8

Përgjegjësitë e Administratës Tatimore

1. Administrata Tatimore është institucioni përgjegjës për prodhimin, administrimin, përpunimin dhe raportimin e të dhënave të nevojshme për përcaktimin e bazës së harmonizuar të TVSH-së, për qëllime të përlllogaritjes së Burimeve të Veta të bazuara në TVSH dhe të Kontributit Kombëtar në buxhetin e Bashkimit Evropian.
2. Për zbatimin e këtij ligji, Administrata Tatimore:
 - a) përgatit, administron dhe vë në dispozicion të dhënat e nevojshme për përlllogaritjen e bazës së harmonizuar të TVSH-së;
 - b) siguron cilësinë, plotësinë, konsistencën dhe gjurmueshmërinë e të dhënave që përdoren për përlllogaritjen e bazës së harmonizuar të TVSH-së;
 - c) dokumenton dhe raporton korigjimet administrative ose metodologjike që ndikojnë në përlllogaritjen e bazës së harmonizuar të TVSH-së dhe të Burimeve të Veta të bazuara në TVSH;

ç) bashkëpunon me Ministrinë përgjegjëse për financat për verifikimin, konsolidimin dhe raportimin e të dhënave që lidhen me Burimet e Veta të bazuara në TVSH;

d) vë në dispozicion të Ministrisë përgjegjëse për financat dokumentacionin, evidencat dhe informacionin mbështetës të nevojshëm për përmbushjen e detyrimeve që lidhen me Burimet e Veta të Bashkimit Evropian;

dh) siguron ruajtjen e dokumentacionit dhe të gjurmës së auditimit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit të Bashkimit Evropian dhe legjislacionit kombëtar në fuqi.

3. Administrata Tatimore i transmeton Ministrisë përgjegjëse për financat, sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet e nxjerra në zbatim të tij, të dhënat dhe informacionin e nevojshëm për përllogaritjen e Burimeve të Veta të bazuara në TVSH.

Neni 9

Ministria përgjegjëse për Mjedisin

1. Ministria përgjegjëse për mjedisin është institucioni përgjegjës për administrimin, përpunimin, përllogaritjen dhe dokumentimin e të dhënave administrative sektoriale mbi

mbetje të paketimit plastik që nuk riciklohen , në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe acquis të Bashkimit Evropian.

2. Për zbatimin e këtij ligji, ministria përgjegjëse për mjedisin:

a) organizon dhe administron mbledhjen e të dhënave mbi mbetjet e paketimit plastik që nuk riciklohen në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian;

b) përllogarit treguesit kombëtarë mbi gjenerimin, riciklimin dhe trajtimin e mbetjeve të paketimit plastik që nuk riciklohen sipas metodologjive të përcaktuara nga legjislacioni i Bashkimit Evropian;

c) siguron cilësinë, plotësinë, saktësinë dhe gjurmueshmërinë e të dhënave dhe dokumentacionit metodologjik që përdoren për përllogaritjen e treguesve të parashikuar në shkronjën “b” të kësaj pike;

ç) administron funksionalisht regjistrat dhe sistemet e informacionit që lidhen me të dhënat e nevojshme për përllogaritjen e Burimeve të Veta të bazuara në mbetjet e paketimeve plastik që nuk riciklohen

d) përgatit dhe vë në dispozicion të institucioneve përgjegjëse dokumentacionin metodologjik, raportet dhe informacionin e nevojshëm për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj;

dh) bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për financat dhe Institutin e Statistikave për shkëmbimin e informacionit dhe harmonizimin e të dhënave që lidhen me Burimet e Veta të bazuara në mbetjet e paketimeve plastike që nuk riciklohen;

e) ruan dokumentacionin dhe evidencat mbështetëse në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

3.Ministria përgjegjëse për mjedisin i transmeton ministrisë përgjegjëse për financat, sipas afateve të përcaktuara në nenin 11 të këtij ligji:

a) parashikimet vjetore dhe afatmesme mbi sasinë e mbetjeve të paketimeve plastike që nuk riciklohen për qëllime të planifikimit buxhetor;

b) të dhënat përfundimtare dhe dokumentacionin metodologjik që shërbejnë për përlllogaritjen e Burimeve të Veta të bazuara në mbetjet e paketimeve plastike që nuk riciklohen

KREU III

PROCEDURA E PLANIFIKIMIT, LLOGARITJES, ÇERTIFIKIMIT, RAPORTIMIT DHE VËNIES NË DISPOZICION TË KONTRIBUTIT KOMBËTAR NË BUXHETIN E BASHKIMIT EUROPIAN

Neni 10

Planifikimi buxhetor i Kontributit Kombëtar dhe trajtimi i rishikimeve dhe korrigjimeve financiare

1. Ministria përgjegjëse për financat siguron planifikimin e Kontributit Kombëtar në buxhetin e shtetit, në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe me parashikimet e institucioneve përgjegjëse për Burimet e Veta të Bashkimit Evropian.
2. Për qëllime të Programit Buxhetor Afatmesëm, institucionet përgjegjëse për prodhimin ose administrimin e të dhënave mbi Burimet e Veta i paraqesin Ministrisë përgjegjëse për financat parashikimet vjetore dhe afatmesme për:

a) Burimet Tradicionale Vetjake;

- b) Burimin e bazuar në TVSH;
 - c) Burimin e bazuar në të Ardhurat Kombëtare Bruto (AKB);
 - ç) Burimin e bazuar në mbetjet e paketimeve plastike qw nuk riciklohen
 - d) çdo kategori tjetër të Burimeve të Veta të Bashkimit Evropian të parashikuar nga acquis i Bashkimit Evropian.
3. Ministria përgjegjëse për financat përfshin në dokumentet buxhetore vjetore dhe afatmesme:
- a) vlerën e parashikuar të Kontributit Kombëtar;
 - b) hapësirat fiskale të nevojshme për përballimin e korrigjimeve të mundshme financiare;
 - c) detyrimet e pritshme që mund të rezultojnë nga rishikimet statistikore, metodologjike ose financiare të kryera nga institucionet kombëtare, Komisioni Evropian ose Eurostat.
4. Korrigjimet financiare që rezultojnë nga:
- a) rishikimi i bazës së harmonizuar të TVSH-së;
 - b) rishikimi i të Ardhurave Kombëtare Bruto (AKB);
 - c) korrigjimi i të dhënave për mbetjet e paketimeve plastike qw nuk riciklohen,
 - ç) misionet e verifikimit dhe auditimit të institucioneve të Bashkimit Evropian;
 - d) administrimi, kontrolli dhe verifikimi i Burimeve Tradicionale të Veta, përfshirë ato që burojnë nga kontrollet e Administratës Doganore dhe misionet e verifikimit të institucioneve të Bashkimit Evropian.
5. Ndryshimet në legjislacionin e Bashkimit Evropian për Burimet e Veta trajtohen si detyrime financiare të Republikës së Shqipërisë dhe pasqyrohen në buxhetin e shtetit në përputhje me legjislacionin në fuqi.
6. Ministria përgjegjëse për financat merr masat e nevojshme për sigurimin e fondeve për përmbushjen e detyrimeve financiare që rrjedhin nga korrigjimet e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni, në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e sistemit buxhetor në fuqi.
7. Interesat e vonesës, penalitetet dhe detyrimet e tjera financiare që lindin nga mospërmbushja në afat e detyrimeve ndaj Bashkimit Evropian evidentohen dhe raportohen veçmas, në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian .
8. Planifikimi, financimi, monitorimi dhe pasqyrimi buxhetor i Kontributit Kombëtar dhe të korrigjimeve financiare që lidhen me të bëhet në përputhje me legjislacionin buxhetor në fuqi.

Neni 11

Afatet e raportimit të të dhënave

1. Administrata Doganore i paraqet Ministrisë përgjegjëse për Financat, jo më vonë se data 15-të e çdo muaji, raportin mbi:
 - a) Gjendjen e llogarisë “A” dhe llogarisë “B”;
 - b) korrigjimet, anulimet dhe rikuperimet;
 - c) çdo informacion tjetër të kërkuar sipas legjislacionit të Bashkimit Evropian.
2. Administrata Tatimore i paraqet Ministrisë përgjegjëse për Financat:
 - a) jo më vonë se data 31 mars e çdo viti, të dhënat e nevojshme për llogaritjen e bazës së harmonizuar të TVSH-së që do të përdoret për përlllogaritjen e kontributit nga TVSH për vitin e ardhshëm buxhetor;
 - b) çdo informacion plotësues ose korrigjues të kërkuar nga Ministria përgjegjëse për Financat ose Komisioni Evropian.
3. Instituti i Statistikave i paraqet ministrisë përgjegjëse për Financat:
 - a) agregatet përfundimtare të AKB-së dhe dokumentacionin shoqërues para transmetimit të tyre në Eurostat, dhe jo më vonë se data 30 shtator e çdo viti, për të mundësuar përmbushjen e detyrimeve që lidhen me burimet e veta të Bashkimit Evropian;
 - b) çdo rishikim metodologjik ose statistikor që ndikon në llogaritjen e AKB;
4. Ministria përgjegjëse për mjedisin, nëpërmjet strukturës përgjegjëse, i paraqet Ministrisë përgjegjëse për financat:
 - a. jo më vonë se java e parë e muajit janar të çdo viti, parashikimet paraprake të sasisë vjetore të mbetjeve të paketimeve plastike që nuk riciklohen;
 - b. Informacionin mbështetës metodologjik për tre vitet buxhetore pasardhëse, për efekt të përlllogaritjes së kontributit kombëtar në kuadër të Burimeve të Veta të bazuara në mbetjet e paketimeve plastike që nuk riciklohen;
 - c. paraqet ministrisë përgjegjëse për financat dhe INSTAT-it, jo më vonë se data 31 mars e çdo viti, të dhënat përfundimtare për vitin paraardhës mbi gjenerimin, riciklimin dhe sasinë e mbetjeve të paketimeve plastike që nuk riciklohen, të shoqëruara me dokumentacionin metodologjik përkatës;
 - d. Siguron zbatimin e saktësisë, plotshmërisë dhe cilësisë së të dhënave administrative dhe të treguesve të përlllogaritur.
5. Ministria përgjegjëse për Financat:

- a) verifikon dhe konsolidon të dhënat e dërguara nga institucionet përgjegjëse;
- b) përgatit llogaritjet, deklaratat dhe raportet zyrtare për Komisionin Evropian;
- c) përllogarit shumat e detyrueshme për transferim në Buxhetin e Bashkimit Evropian.
- d) Jo më vonë se java e dytë e muajit prill të çdo viti, dërgon në organet përgjegjëse të Bashkimit Evropian vlerësimet dhe parashikimet për secilin burim të Kontributit Kombëtar për 3 (vitet) e ardhshme, së bashku me raportin e detajuar të përllogaritjeve të kryera për këtë qëllim;
- e) Jo më vonë se java e dytë e muajit shtator të çdo viti, dërgon në organet përgjegjëse të Bashkimit Evropian vlerësimet dhe parashikimet e përditësuara të secilit burim të Kontributit Kombëtar për 3 (vitet) e ardhshme, së bashku me raportin e detajuar të përllogaritjeve të kryera për këtë qëllim;
- f) Në rast se gjatë verifikimit konstatohet mangësi ose mospërputhje në të dhënat e raportuara nga institucionet përgjegjëse, Ministria përgjegjëse për Financat njofton institucionin përkatës, i cili kryen verifikimet dhe korrigjimet e nevojshme brenda afatit të përcaktuar me aktet nënligjore.

Neni 12

Procedura për vënien në dispozicion të Kontributit Kombëtar në buxhetin e Bashkimit Evropian

1. Republika e Shqipërisë vë në dispozicion të Komisionit Evropian Burimet e Veta të Bashkimit Evropian, në përputhje me afatet, procedurat dhe kërkesat e përcaktuara në legjislacionin e Bashkimit Evropian për sistemin e Burimeve të Veta.
2. Administrimi, përllogaritja dhe vënia në dispozicion e Burimeve Tradicionale të Veta, Burimeve të Veta të bazuara në TVSH, Burimeve të Veta të bazuara në të Ardhurat Kombëtare Bruto (AKB) dhe Burimeve të Veta të bazuara në mbetjet e paketimeve plastike qw nuk riciklohen kryhen në përputhje me rregullat, afatet dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin e Bashkimit Evropian për Burimet e Veta.
3. Pagesat e Kontributit Kombëtar për komponentët e Burimeve të Veta kryhen mbi bazën e thirrjeve për fonde ("Call for Funds") dhe njoftimeve përkatëse të Komisionit Evropian, të cilat përcaktojnë shumat dhe afatet për vënien në dispozicion të fondeve.
4. Në rast të rishikimeve, korrigjimeve ose ndryshimeve të vlerësimeve që ndikojnë në shumën e Kontributit Kombëtar, detyrimet përkatëse trajtohen dhe përmbushen në përputhje me afatet dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin e Bashkimit Evropian për Burimet e Veta.

5. Në rast të mosvënies në dispozicion të shumave brenda afateve të përcaktuara, zbatohen interesat e vonës dhe detyrimet e tjera financiare sipas rregullave të legjislacionit të Bashkimit Evropian për Burimet e Veta.
6. Ministria përgjegjëse për financat siguron që:
 - a. shumat që do të vihen në dispozicion të Komisionit Evropian të përfshihen në planifikimin dhe menaxhimin e likuiditetit e qeverisë;
 - b. të dhënat financiare, statistikore dhe kontabël që shërbejnë për përllogaritjen dhe vënien në dispozicion të Kontributit Kombëtar të jenë të sakta, të plota dhe të dokumentuara;
 - c. korrigjimet statistikore, financiare ose kontabël që ndikojnë në përllogaritjen e Kontributit Kombëtar të reflektohen në përputhje me afatet dhe procedurat e përcaktuara.

KREU IV

MBLEDHJA DHE SHKËMBIMI I TË DHËNAVE

Neni 13

Baza Kombëtare e të Dhënave për Burimet e Veta të Bashkimit Evropian

1. Ministria përgjegjëse për financat, në cilësinë e Autoritetit Kombëtar Koordinues, është përgjegjëse për administrimin e Bazës Kombëtare të të Dhënave për Burimet e Veta të Bashkimit Evropian.
2. Baza Kombëtare e të Dhënave shërben për grumbullimin, administrimin, konsolidimin, verifikimin dhe ruajtjen e të dhënave që përdoren për përllogaritjen, raportimin dhe monitorimin e Kontributit Kombëtar në buxhetin e Bashkimit Evropian.
3. Baza Kombëtare e të Dhënave përmban, sipas rastit:
 - a) të dhënat dhe evidencat që lidhen me Burimet Tradicionale të Veta;
 - b) të dhënat që lidhen me bazën e harmonizuar të TVSH-së;
 - c) të dhënat statistikore dhe metodologjike që lidhen me të Ardhurat Kombëtare Bruto;
 - ç) të dhënat që lidhen me Burimet e Veta të bazuar në mbetjet e paketimeve plastike që nuk riciklohen;
 - d) dokumentacionin metodologjik, metadatat dhe gjurmën e auditimit për të gjitha llojet e burimeve që përbëjnë Kontributin Kombëtar në BE;

dh) informacionin mbi deklarinmet, korigjimmet, vënie në dispozicion, detyrimet e papaguara dhe interesat e vonesës, kur aplikohen.

4. Institucionet përgjegjëse sipas këtij ligji transmetojnë dhe vënë në dispozicion të Bazës Kombëtare të të Dhënave informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm, në përputhje me kompetencat e tyre dhe kërkesat e këtij ligji.
5. Administrimi i Bazës Kombëtare të të Dhënave bazohet në parimet e ligjshmërisë, integritetit, saktësisë, sigurisë së informacionit, gjurmueshmërisë dhe mbrojtjes së të dhënave.
6. Rregullat teknike për administrimin, funksionimin, ndërveprimin me sistemet e tjera, shkëmbimin elektronik dhe sigurinë e të dhënave miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për financat.

Neni 14

Kalendari dhe periodiciteti i raportimit

1. Institucionet përgjegjëse sipas këtij ligji raportojnë të dhënat dhe informacionin e nevojshëm për Burimet e Veta të Bashkimit Evropian në përputhje me kërkesat e legjislacionit të Bashkimit Evropian dhe kalendarin kombëtar të raportimit

2. Raportimi kryhet sipas periodicitetit të mëposhtëm:

a) të dhënat që lidhen me Burimet Tradicionale të Veta raportohen në baza mujore ose sipas kërkesave të legjislacionit të Bashkimit Evropian;

b) të dhënat që lidhen me bazën e harmonizuar të TVSH-së raportohen në baza periodike, sipas kërkesave të legjislacionit të Bashkimit Evropian

c) të dhënat që lidhen me të Ardhurat Kombëtare Bruto raportohen në përputhje me kalendarin e raportimit të Eurostat-it

ç) të dhënat që lidhen me mbetjet e paketimeve plastike që nuk riciklohen raportohen në baza vjetore ose sipas kërkesave të legjislacionit të Bashkimit Evropian.

3. Ministria përgjegjëse për financat, në cilësinë e Autoritetit Kombëtar Koordinues, publikon dhe përditëson kalendarin kombëtar të raportimit për Burimet e Veta të Bashkimit Evropian, në përputhje me afatet dhe kërkesat e legjislacionit të Bashkimit Evropian.

KREU V

AUDITIMI, KONTROLLI I JASHTËM DHE VERIFIKIMI NDËRKOMBËTAR

Neni 15

Auditimi dhe kontrolli i të dhënave për Burimet e Veta

1. Të dhënat, sistemet dhe proceset e përdorura për përlogaritjen, raportimin dhe administrimin e Burimeve të Veta të Bashkimit Evropian i nënshtrohen auditimit dhe kontrollit me qëllim garantimin e ligjshmërisë, saktësisë, plotësisë, gjurmueshmërisë dhe besueshmërisë së tyre.
2. Auditimi i proceseve dhe i të dhënave të përdorura për Burimet e Veta kryhet nga:
 - a) strukturat përgjegjëse për auditimin e brendshëm në ministrinë përgjegjëse për financat;
 - b) njësitë e auditimit të brendshëm në institucionet përgjegjëse, sipas kompetencave të tyre.
3. Autoritetet e auditimit verifikojnë:
 - a) përputhshmërinë metodologjike të të dhënave;
 - b) gjurmueshmërinë e plotë të të dhënave dhe proceseve
 - c) integritetin, besueshmërinë dhe sigurinë e sistemeve të raportimit;
 - ç) korrektësinë e proceseve të përpunimit, konsolidimit dhe raportimit;
 - d) ekzistencën, plotësinë dhe ruajtjen e dokumentacionit mbështetës;
 - dh) funksionimin efektiv të mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe të sigurimit të cilësisë së të dhënave.
4. Institucionet përgjegjëse sigurojnë ruajtjen e dokumentacionit, evidencave mbështetëse, metadata-ve dhe gjurmës së auditimit në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi.
5. Pas anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, institucionet përgjegjëse bashkëpunojnë me Komisionin Evropian dhe institucionet e tjera kompetente të Bashkimit Evropian gjatë verifikimeve, kontrolleve dhe auditimeve që lidhen me administrimin e Burimeve të Veta, në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Neni 16

Verifikimi dhe auditimi nga institucionet e Bashkimit Evropian

1. Pas anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, të dhënat, dokumentacioni dhe proceset që lidhen me administrimin e Burimeve të Veta i nënshtrohen verifikimit dhe kontrollit nga institucionet kompetente të Bashkimit Evropian, në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian
2. Verifikimet dhe kontrollet sipas pikës 1 të këtij neni mund të kryhen nga:
 - a) Komisioni Evropian;
 - b) Eurostat;
 - c) Gjykata Evropiane e Audituesve;
 - ç) institucione ose organe të tjera kompetente të Bashkimit Evropian, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Ministria përgjegjëse për financat, në cilësinë e Autoritetit Kombëtar Koordinues, koordinon në nivel kombëtar përgatitjen dhe zhvillimin e misionëve të verifikimit dhe kontrollit.
4. Institucionet përgjegjëse janë të detyruara:
 - a) të bashkëpunojnë me ekipet e verifikimit dhe kontrollit;
 - b) të vënë në dispozicion dokumentacionin, evidencat dhe informacionin e kërkuar;
 - c) të sigurojnë akses në të dhënat, regjistrat administrativë dhe dokumentacionin metodologjik që lidhet me Burimet e Veta;
 - ç) të japin shpjegimet dhe sqarimet e nevojshme gjatë proceseve të verifikimit dhe kontrollit.
5. Gjetjet dhe rekomandimet e verifikimeve dhe kontrolleve u komunikohen institucioneve përgjegjëse për marrjen e masave përkatëse, sipas kompetencave të tyre.

Neni 17

Detyrimi për bashkëpunim institucional

1. Institucionet përgjegjëse sipas këtij ligji janë të detyruara të bashkëpunojnë ndërmjet tyre dhe me ministrinë përgjegjëse për financat për përmbushjen e detyrimeve që lidhen me administrimin, raportimin, kontrollin dhe auditimin e Burimeve të Veta të Bashkimit Evropian.
2. Bashkëpunimi institucional përfshin, sipas rastit:

- a) shkëmbimin e të dhënave, informacionit dhe dokumentacionit të nevojshëm;
- b) ofrimin e shpjegimeve dhe sqarimeve teknike e metodologjike;
- c) koordinimin e veprimeve për përmbushjen e rekomandimeve dhe masave korrigjuese;
- ç) mbështetjen e proceseve të kontrollit, auditimit dhe verifikimit të kryera nga autoritetet kombëtare dhe institucionet e Bashkimit Evropian.

4. Shkëmbimi i të dhënave dhe informacionit sipas këtij neni kryhet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, sigurinë e informacionit dhe dispozitat e tjera të zbatueshme.

Neni 18

Rezultatet e auditimit dhe masat korrigjuese

1. Kur auditimi, kontrolli ose verifikimi identifikon mangësi në të dhëna, procese ose sisteme, institucioni përgjegjës merr masat e nevojshme për korrigjimin e tyre, sipas kompetencave të përcaktuara në këtë ligj², Institucioni përgjegjës harton një plan korrigjues i cili përfshin:

- a) korrigjimin e të dhënave të pasakta;
- b) rishikimin e metodologjisë;
- c) përmirësimin e sistemeve të informacionit dhe proceseve të administrimit të të dhënave që lidhen me Burimet e Veta
- ç) ngritjen e kapaciteteve institucionale

3. Autoriteti Kombëtar Koordinues monitoron zbatimin e masave korrigjuese dhe koordinon veprimet ndër-institucionale kur mangësitë e identifikuara prekin më shumë se një institucion

KREU VI

Shkeljet dhe masat korrigjuese

Neni 19

1. Përbëjnë shkelje të detyrimeve të parashikuara në këtë ligj:

- a) mosdorëzimi i të dhënave, informacionit ose dokumentacionit brenda afateve të përcaktuara;

- c) dorëzimi i të dhënave ose informacionit të pasaktë, të paplotë ose të pambështetur me dokumentacionin përkatës;
- ç) mosrespektimi i standardeve metodologjike dhe procedurave të miratuara për administrimin, përpunimin, konsolidimin dhe raportimin e të dhënave;
- d) mosruajtja e dokumentacionit mbështetës, metadata-ve ose gjurmës së auditimit (audit trail);
- dh) mosbashkëpunimi gjatë procedurave të kontrollit, verifikimit dhe auditimit.

2. Për zbatimin e detyrimeve të parashikuara në këtë ligj përgjegjësi mbajnë, sipas kompetencave të tyre

- a) institucioni përgjegjës;
- b) titullari i institucionit, për organizimin dhe funksionimin e sistemit të administrimit të të dhënave;
- c) njësia organizative për administrimin, përgatitjen, verifikimin dhe raportimin e të dhënave;
- ç) pronari i të dhënave (Data Oëner), sipas kompetencave të përcaktuara;

2. Kur konstatohet një nga shkeljet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, institucioni përgjegjës është i detyruar të marrë masat e nevojshme korrigjuese për eliminimin e parregullsive dhe rikthimin e përputhshmërisë me kërkesat e këtij ligj

3. Ministria përgjegjëse për financat njofton me shkrim institucionin përgjegjës për shkeljen e konstatuar dhe kërkon marrjen e masave korrigjuese brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit, përveç rasteve kur legjislacioni i posaçëm parashikon një afat tjetër.

4. Në rast të mosmarrjes së masave korrigjuese brenda afatit të përcaktuar, Ministria përgjegjëse për financat njofton organet kompetente për fillimin e procedurave administrative ose disiplinore, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Kur shkeljet e parashikuara në këtë nen shkaktojnë ose mund të shkaktojnë pasoja financiare për Republikën e Shqipërisë ose cenojnë përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i Bashkimit Evropian për Burimet e Veta, personat dhe institucionet përgjegjëse mbajnë përgjegjësi administrative, disiplinore, civile ose penale, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Zbatimi i këtij neni nuk cenon përgjegjësitë e parashikuara në legjislacionin për kontrollin e brendshëm financiar publik, auditimin e brendshëm, administrimin e financave publike, statistikave zyrtare, administratën doganore, administratën tatimore dhe legjislacionin tjetër të posaçëm.

KREU VII

DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 20

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji miratohen brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e tij.

2. Për zbatimin e këtij ligji:

a) Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për financat, miraton rregullat për organizimin dhe funksionimin e Komitetit Kombëtar për Kontributin Kombëtar në Bashkimin Evropian dhe të Sekretariatit Teknik, sipas nenit 4, pika 4, të këtij ligji;

b) ministri përgjegjës për financat miraton rregullat dhe procedurat për administrimin e Llogarisë “A” dhe Llogarisë “B”, formatet e raportimit, shkëmbimin elektronik të të dhënave dhe përdorimin e formularëve standardë të Komisionit Evropian, sipas nenit 7, pika 7, të këtij ligji;

c) Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për financat, miraton rregullat teknike për administrimin, funksionimin, ndërveprimin me sistemet e tjera, shkëmbimin elektronik dhe sigurinë e të dhënave të Bazës Kombëtare të të Dhënave për Burimet e Veta të Bashkimit Evropian, sipas nenit 13, pika 6, të këtij ligji.

ç) ministri përgjegjës për mjedisin miraton aktin nënligjor për përafrimin e akteve të zbatueshme të Bashkimit Evropian në fushën e llogaritjes së Burimeve të Veta të bazuara në mbetjet plastike të paketimeve të pa ricikluara.

3. Aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij ligji nuk mund të ndryshojnë ose të kufizojnë të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e përcaktuara në këtë ligj

Neni 21

Masat kalimtare dhe zbatimi i detyrimeve pas anëtarësimit

1. Deri në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, institucionet përgjegjëse marrin masat organizative, administrative dhe teknike të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në këtë ligj

2. Brenda 24 (njëzet e katër) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, institucionet përgjegjëse sigurojnë:

a) ngritjen dhe funksionimin e strukturave përgjegjëse;

b) zhvillimin dhe funksionimin e sistemeve të informacionit dhe të Bazës Kombëtare të të Dhënave;

c) miratimin dhe zbatimin e procedurave për mbledhjen, përpunimin, shkëmbimin dhe raportimin e të dhënave;

ç) përgatitjen dhe trajnimin e personelit përgjegjës për zbatimin e këtij ligji.

3. Detyrimet që lidhen me përllogaritjen, deklarimin, vënien në dispozicion të Burimeve të Veta të Bashkimit Evropian, transferimin e Kontributit Kombëtar në Buxhetin e Bashkimit Evropian dhe detyrimet e tjera financiare që burojnë nga legjislacioni i Bashkimit Evropian zbatohen nga data e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Neni 22

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Niko Peleshi